




Silva Nini

Hazir Haziri

Zeni Ballazhi

Edukatë

FIGURATIVE



Edukatë

FIGURATIVE



ISBN: 978-9951-786-85-0



9 789951 786850

BOTIME



Silva Nini

Hazir Haziri

Zeni Ballazhi

EDUKATË FIGURATIVE 1

Për klasën e parë të arsimit 9-vjeçar

BOTIME



Prishtinë, 2023



BOTIME



Drejtoi botimin: Arlinda RRUSHI
Recensentë të MASHTI-t:
Redaktore: Brunilda MENO
Korrektore letrare: Ornela LECI
Paraqitja grafike: Suela NINI, Florinda ZONJA
Kopertina: Suela NINI
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN: 978-9951-786-85-0


© Botime Pegi sh.p.k, dega në Kosovë, gusht 2023
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: cel: +355 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Spektori i shpërndarjes: cel: +355 069 20 267 73; 069 40 106 88;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com



Hyrje


Libri “Edukatë figurative 1” u shërben nxënësve për të krijuar përvoja të reja në art. Këto përvoja i ndihmojnë ata për ta çmuar e për ta vlerësuar artin, mbi të gjitha, për të kuptuar se rrugët e krijimit të tij janë të shumëllojshme. Art figurativ do të thotë të vizatosh, të pikturosh, të ngjyrosësh, të modelosh, të presësh, të ngjitësh, të endësh etj. Art figurativ do të thotë të shohësh dhe të shprehësh. Arti është pasqyrim i botës së brendshme të njeriut.





PËRMBAJTJE

Çdo piktor është i veçantë	6
Elementet e artit	8
Vijat horizontale, vertikale dhe diagonale	10
Punim me vija, me letër punëdore	12
Lloje të ndryshme vijash	14
Mjetet e vizatimit	16
Forma dydimensionale	18
Forma gjeometrike	20
Zbulojmë forma të ndryshme	22
Ngjyrat primare	24
Ngjyrat dhe emocionet	26
Pikturë me tri ngjyra	28
Ngjyrat sekondare	30
Si të përdorim penelin	32
Pikturë me akualet	34
Flutura dhe ngjyrat	36
Tekstura	38
Krijimi im me tekstura	40



Tekstura reale	42
Endja e qilimit	44
Kolazhi	46
Teknika e shtypit (I)	48
Teknika e shtypit (II)	50
Teknika e shtypit (III)	52
Forma tredimensionale	54
Forma dy- dhe tredimensionale	56
Trupat gjeometrikë me plastelinë	58
Hapësira	60
Tradita e poçerisë	62
Mozaiiku	64
Lulet e diellit sipas Van Gogut	66
Peizazh vjeshte sipas Ismail Lulanit	68
Kulla sipas Muslim Mulliqit	70
Krahasojmë dy vepra arti	72
Vizitë në studion e piktorit	74
Fjalorthi	
Referenca	



1. ÇDO PIKTOR ËSHTË I VEÇANTË

Shiko pikturat me pemë të realizuara nga piktorë të ndryshëm. A janë pikturuar pemët në të njëjtën mënyrë?



Piet Mondrian, "Pema e kuqe"



Shaip Çitaku, "Peizazh", 1986

- Çdo piktor është i veçantë. Ai na ndihmon ta shohim në një mënyrë të re, mjedisin që na rrethon.

KRIJIMI IM

Në natyrë pemët janë të shumëllojshme.



- Vizato edhe ti një pemë.
Pema mund të jetë e vërtetë ose e përfytyruar.



Pemë të vizatuara nga nxënës.

Vlerëso krijimin tënd


Diskuto me shokët dhe shoqet e klasës si e ke realizuar pemën tënde. Pema jote është e veçantë, ashtu siç je dhe ti.

Mjetet e punës:


fletë vizatimi,
lapsa me ngjyra.

2. ELEMENTET E ARTIT


Shiko gjethet dhe gjej dallimet mes tyre.



Vija



Format e gjetheve



Format dhe ngjyrat e gjetheve



Forma, ngjyra dhe tekstura



Hapësira dhe forma tredimensionale

KRIJIMI IM

Vendos dy ose me shumë gjethe poshtë fletës së vizatimit. Zgjidh dy ose tri ngjyra pasteli dhe ngjyros fort mbi letër. Imazhet e gjetheve do të bëhen të dukshme.



Vlerëso krijimin tënd



Tregoju shokëve dhe shoqëve punimin tënd dhe shpjego si e realizove.

Mjetet e punës:


gjethe, fletë vizatimi, pastele.

3. VIJAT HORIZONTALE, VERTIKALE DHE DIAGONALE


Shiko figurën dhe lidh me shigjetë sipas shembujve të dhënë.



Vija horizontale



Vija vertikale



Vija diagonale

Vijat marrin emrin e vendit që përshkojnë në hapësirë.

Ato janë: **horizontale**, **vertikale** dhe **diagonale**.

- Gjeni në mjedisin përreth vija horizontale, vertikale dhe diagonale.


EKSPERIMENTI IM

Vizato llojet e vijave sipas ndarjeve.

Përdor **vija të trasha** ose **të holla**,

të plota ose **të shkëputura**.

Përdor **ngjyrat** sipas dëshirës.



Vlerëso krijimin tënd


Tregoju shokëve dhe shoqeve si e realizove punimin.

Mjetet e punës:

lapsa me ngjyra ose flamastera.

4. PUNIM ME VIJA ME LETËR PUNËDORE


Shiko dhe kujto.
Vija mund të jetë:



Horizontale




Vertikale




Diagonale



E trashë



E hollë




Pingule



E pandërprerë



E ndërprerë




Paralele

KRIJIMI IM

Krijo një punim me vija.

- Prit shirita letre me ngjyra dhe trashësi të ndryshme.
- Ngjiti shiritat në fletë në mënyrë vertikale, horizontale dhe diagonale, si në figurë.



Vlerëso krijimin tënd




Tregoju shokëve dhe shoqëve punimin tënd dhe shpjego si e realizove.

Mjetet e punës:

letra me ngjyra, gërshërë, ngjitës.

5. LLOJE TË NDRYSHME VIJASH


Shiko llojet e ndryshme të vijave: e shkallëzuar, e pikëzuar, e përdredhur, e harkuar, e valëzuar, e ndërprerë, zigzage, spirale. Vendos emërtimin e duhur poshtë çdo figure.



● Gjej në natyrë shembuj të ndryshëm të vijave.

KRIJIMI IM

- 1 Ndaj një fletë të bardhë në tetë pjesë të barabarta.
- 2 Vizato në secilën pjesë, lloje të ndryshme të vijave.



Vlerëso krijimin tënd

Tregoju shokëve dhe shoqëve punimin tënd. Emërto vijat që ke përdorur.

Mjetet e punës:

fletë vizatimi,
lapsa me ngjyra
ose flamastera.

6. MJETET E VIZATIMIT

Shiko figurat e mjeteve të vizatimit dhe vendos emërtimin e duhur poshtë secilës prej tyre (*flamastera, lapsa me ngjyra, pastele, lapsa*).



Çdo mjet me të cilin mund të realizojmë vijën, mund ta përdorim për të vizatuar. Mjetet e vizatimit kanë karakteristika të veçanta. Lapsi është mjeti më i përdorur për vizatim.



- **Vizatimi** është një teknikë shumë e vjetër.



Pikturë shpelle në Francë, e realizuar në lashtësi.

KRIJIMI IM

Plotëso figurën e lepurit dhe mjedisin përreth tij.
Vepra sipas shembullit të dhënë.



Vlerëso krijimin tënd

Tregoju shokëve dhe shoqëve punimin tënd.
Diskutoni së bashku për mjetet e vizatimit.

Mjetet e punës:

fletë vizatimi, laps,
lapsa me ngjyra
ose pastelev.

7. FORMA DYDIMENSIONALE

Shiko dhe dallo ndryshimin midis objektit në fotografi dhe objektit në vizatim.



Fig. 1




Fig. 2



Fig. 3







Fig. 4

- Molla dhe vazoja në fotografi shfaqen në formën **tredimensionale** (me vëllim). Molla dhe vazoja në vizatim shfaqen në formën **dydimensionale** (të sheshtë).
- Nëpërmjet vijës së mbyllur, ne krijojmë formën dydimensionale të objekteve.
- Vija që përshkruan formën e objektit quhet **kontur**.



KRIJIMI IM

Vizato formën dydimensionale të këtyre objekteve.



Vlerëso krijimin tënd



Tregoju shokëve dhe shoqëve punimin tënd. Diskutoni së bashku për format e objekteve.

Mjetet e punës:

fletë vizatimi, laps, gomë.



8. FORMA GJEOMETRIKE

Shiko dhe emërto format gjeometrike.





1 Sa brinjë ka katrori?

2 A janë pikat e rrethit të baraslarguara nga qendra?






3 Sa brinjë ka trekëndëshi?

4 Si janë të vendosura brinjët e drejtkëndëshit?



KRIJIMI IM

Vizato rrethin, trekëndëshin dhe katrorin.
Përdor letër të verdhë, të kaltër dhe të kuqe.
Priti format me gërshërë dhe ngjiti mbi një fletë të bardhë.
Kombinoji sipas dëshirës.



Vlerëso krijimin tënd


Tregoju shokëve dhe shoqëve punimin tënd.
Shpjego si i ke kombinuar figurat
gjeometrike.

Mjetet e punës:


laps, letra me
ngjyra, gërshërë,
ngjitës.

9. ZBULOJMË FORMA TË NDRYSHME

Shiko dhe emërto format e objekteve (*katror, rreth, trekëndësh, drejtkëndësh*).



Objekte me forma të çrregullta



- Format e disa objekteve janë të ngjashme me **format gjeometrike**. Forma të tilla quhen **të rregullta**.
- Format e disa objekteve të tjera janë **të çrregullta**.

KËRKIMI IM

Shiko tabelën e mëposhtme. Vizato në *Fletoren e punës* shembuj të ngjashëm me format e dhëna.

KËRKIM MBI FORMËN	
OBJEKTE ME FORMA TË RREGULLTA (GJEOMETRIKE)	
Rreth	Katror
	
Çfarë është? DIELL	Çfarë është? DHURATË
Drejkëndësh	Trekëndësh
	
Çfarë është? DERË	Çfarë është? ÇATI
OBJEKTE ME FORMA TË ÇRREGULLTA	
	
Çfarë është? GJETHE	Çfarë është? ZOG

Vlerëso krijimin tënd

Tregoju shokëve dhe shoqeve punimin tënd. Shpjego si i ke vizatuar objektet.

Mjetet e punës:

lapsa me ngjyra ose flamastera.

10. NGJYRAT PRIMARE



Shiko ngjyrat dhe gjej shembuj të tjerë të objekteve me të njëjtën ngjyrë.



- **Ngjyrat primare** (parësore) janë: **e verdha**, **e kuqja** dhe **e kaltra**. Nga përzierja e tyre krijohen ngjyrat e tjera.


KRIJIMI IM

- ① **Vizato** tre katrorë të mëdhenj në letër të verdhë, tre në letër të kuqe dhe tre në letër të kaltër. Priti me gërshërë.



- ② Vizato tre katrorë të vegjël për secilën ngjyrë dhe prit.

- ③ Ngjiti katrorët si në figurë, duke i kombinuar sipas dëshirës.



Vlerëso krijimin tënd

Tregoju shokëve dhe shoqëve punimin tënd. Shpjego si i ke kombinuar ngjyrat.

Mjetet e punës:

letër me ngjyra (e verdhë, e kuqe, e kaltër), gërshërë, vizore, laps, ngjitës.

11. NGJYRAT DHE EMOCIONET

Çfarë emocionesh të shkaktojnë ngjyrat?

E verdha



Gëzim




Ngrohtësi

E kaltra



Mërzi



Ftohtësi

E kuqja



Zemërim



Nxehtësi

KRIJIMI IM

Krijo tri vizatime. Përdor një ngjyrë primare për secilin prej tyre.



Vlerëso krijimin tënd

Gruponi në klasë vizatimet sipas ngjyrave. Çfarë emocionesh të krijojnë ngjyrat e secilit grup?

Mjetet e punës:

fletë vizatimi, lapsa me ngjyra ose flamastera.

12. PIKTURË ME TRI NGJYRA

Shiko pikturat dhe gjej ngjyrat që janë përdorur.




Roi Lihtenshtein



Henri Matis



Henri Matis



Roi Lihtenshtein

Përdor edhe ti **tri ngjyrat primare** në krijimin tënd.

KRIJIMI IM

Zgjidh njërën nga këto tema për të realizuar krijimin tënd.

- *Shportë me fruta*
- *Top në breg të detit*
- *Varkë me vela*
- *Ujitëse lulesh*

Përdor ngjyrën e verdhë, të kuqe dhe të kaltër.



Vlerëso krijimin tënd

Diskuto me shokët e shoqet për ngjyrat që ke përdorur në krijimin tënd.

Mjetet e punës:

akuarel, penela me madhësi të ndryshme.

13. NGJYRAT SEKONDARE

Shiko dhe kujto.

Çfarë ndodh kur përziejmë ngjyrat primare?



E kaltër + e verdhë = ?

E verdhë + e kuqe = ?



E kaltër + e kuqe = ?

Kur përziejmë ngjyrat primare, krijohen **ngjyrat sekondare** (dytësore).



Portokalli




E gjelbër



Vjollcë

EKSPERIMENTI IM

Përzieji ngjyrat sipas shembullit të dhënë, për të plotësuar rathët në *Fletoren e punës*.



14. SI TA PËRDORIM PENELIN

Penelat i përdorim për të pikturuar. Ata kanë madhësi të ndryshme.





Për penelin duhet të tregojmë kujdes të veçantë. Ai na ndihmon të krijojmë piktura të bukura.




Mbaje pastër penelin tënd.

Flokët e penelit duhet të kenë të njëjtin drejtim.



Mos e shtyp fort penelin kur merr ngjyrën dhe pikturon mbi letër.



Vendose penelin në gotë, si në figurë.

Peneli duhet lagur vazhdimisht me ujë.

EKSPERIMENTI IM

Eksperimento me penelin dhe ngjyrat sipas hapave të mëposhtëm.



Njome penelin në gotën me ujë.



Merr me penel ngjyrën që dëshiron.



Pikturo me penel mbi fletë.



Kur ndërron ngjyrën, shpëlaje penelin në ujë të pastër.



Merr me penel një ngjyrë tjetër.



Vazhdo kështu me të gjitha ngjyrat.

Vlerëso krijimin tënd

Diskuto me shokët dhe shoqet e klasës për mënyrën si e realizove punimin tënd.

Mjetet e punës:

një gotë me ujë, penel, ngjyra uji, fletë vizatimi.

15. PIKTURË ME AKUAREL

Shiko pikturat e realizuara me **akuarel**.

Çfarë paraqesin ato?

Vendos titullin e duhur pranë secilës pikturë.

(“Peizazh”, “Buqetë me lule”).

Çfarë ngjyrash kanë përdorur piktorët?



Raul Dyfi, 1937



Vlada Radoviç, 1975

KRIJIMI IM

Krijo një pikturë me akuarel.

Zgjidh një nga temat e mëposhtme:

- *Vjeshta dhe gjethet*
- *Dimri dhe plaku i dëborës*
- *Vera dhe deti*
- *Pranvera dhe lulet*

Përdor ngjyrat sipas temës që do të zgjedhësh.



Vlerëso krijimin tënd

Tregoju shokëve dhe shoqeve punimin tënd. Shpjego cilën temë zgjodhe dhe ngjyrat që ke përdorur.

Mjetet e punës:

letër, laps, akuarel, penel, gotë me ujë.

16. FLUTURA DHE NGJYRAT

Shiko fotografitë e mëposhtme dhe fluturën e pikturuar nga piktori.



- A janë të barabartë krahët e fluturës?
- Po ngjyrat, a janë të njëjta në të dy krahët?



Erik Karle, "Ilustrim i fluturës"

KRIJIMI IM

Flutura i ka të dy krahët të barabartë. Ata kanë të njëjtën **ngjyrë** dhe **formë**. Krijë edhe ti një flutur, duke ndjekur hapat si në figurë.



Vlerëso krijimin tënd

Tregojë shokëve dhe shoqëve punimin tënd. Shpjego si e realizove dhe cilat ngjyra përdore.

Mjetet e punës:

letër me ngjyra, akuarel, penela, gërsërë, ngjitës.

17. TEKSTURA

Shiko me vëmendje objektet e paraqitura në figura. Shkruaj poshtë secilës figurë fjalën që e përshkruan më mirë sipërfaqen e objektit (*gjembore, e ashpër, e butë, kokrrizore, e fortë, e copëzuar*).




.....



.....



.....



.....



.....





.....


- Karakteristikat e sipërfaqes i quajmë **teksturë**.
Tekstura mund të shihet dhe të preket.

EKSPERIMENTI IM

- Zgjidh sipërfaqe me tekstura të ndryshme.
- Zgjidh pastelet sipas dëshirës.
- Ndaje fletën e vizatimit në 6 katrorë dhe priti.
- Vendose secilin katror mbi një nga teksturat dhe ngjyrose.



- Ngjiti të gjithë katrorët mbi letër.



Vlerëso krijimin tënd




Tregojtu shokëve dhe shoqëve punimin tënd. Shpjego se çfarë teksturash zgjodhe.

Mjetet e punës:


tekstura të ndryshme, pastelet, letër dhe ngjites.

18. KRIJIMI IM ME TEKSTURA

Përzgjidh disa tekstura.



Vizato një kungull ose një objekt tjetër. Ndaje në disa hapësira. Zgjidh një teksturë për çdo pjesë.



SHEMBUJ PUNIMESH

Në këtë mënyrë mund të realizosh edhe punime të tjera.



Vlerëso krijimin tënd

Tregoju shokëve dhe shoqëve punimin tënd. Shpjego cilat tekstura ke përdorur.

Mjetet e punës:


tekstura të ndryshme, laps, gomë, pastele ose lapsa me ngjyra.

19. TEKSTURA REALE

Krijo një **teksturë reale**. Ndiq hapat e dhënë në figurat e mëposhtme.



1. Zgjidh një fletë të bardhë ose me ngjyrë.




2. Ndaje fletën në 4 pjesë.




3. Palose një të pjesë dhe vizato në të disa vija diagonale, si në figurë. Kështu vepron edhe me pjesën tjetër.



4. Priti vijat me gërshërë.



5. Hape fletën dhe palose si në figurë.



6. Ndiq të njëjtën rrugë edhe për ndarjet e tjera.

Vlerëso krijimin tënd


Diskuto me shokët dhe shoqet e klasës për ndryshimin midis teksturës së vizatuar dhe asaj reale.

Mjetet e punës:

letër, laps, gërshërë.

20. ENDJA E QILIMIT

Shiko qilimin. Figura që përsëritet quhet **motiv**.



Qilim i Drenicës

Motiv


Motivet e qilimit krijojnë teksturën që shihet me sy.
Fijet e endura krijojnë teksturën e prekshme (reale).




KRIJIMI IM

End një qilim me shirita letre me ngjyra, duke ndjekur hapat e dhënë:

1. Palose letrën në dy pjesë.
2. Vizato në të shirita me gjerësi 1 cm (ose 1,5 cm).
3. Priti shiritat me gërshërë.
4. Në të njëjtën mënyrë vepro edhe me letrën tjetër.
5. Realizo endjen një po, një jo, si në figurë.



Shiritat mund t'i presësh në formë zigzage ose të harkuar.



Vlerëso krijimin tënd


Diskuto me shokët dhe shoqet e klasës për mënyrën se si e ende qilimin.

Mjetet e punës:

letra me ngjyra, laps, vizore, gërshërë

21. KOLAZHI

Shiko kolazhin e Pikasos. Cilat materiale janë përdorur aty? A paraqesin tekstura të ndryshme këto materiale?



- **Kolazhi** realizohet me materiale të prera dhe të ngjitura mbi një sipërfaqe. Realizo edhe ti një kolazh me tekstura të ndryshme.

KRIJIMI IM

Krijo tekstura të ndryshme me letra nëpërmjet:

- prerjes
- palosjes
- rrotullimit
- thurjes
- zhubrosjes
- ngjitjes.



Ngjiti pjesët e krijuara mbi një letër me ngjyrë.



Vlerëso krijimin tënd

Tregoju shokëve dhe shoqëve punimin tënd. Shpjego mënyrën si e realizove.

Mjetet e punës:

letra me ngjyra, gërshërë, ngjitës.

22. TEKNIKA E SHTYPIT (I)

Shiko dhe përshkruaj motivet që sheh.





- Këto motive janë realizuar me **teknikën e shtypit**. Edhe ti mund të krijosh me këtë teknikë.

KRIJIMI IM

Përgatit modelin për shtyp me ngjyrën që dëshiron. Vepro si në figurat e mëposhtme.



- Ndaje fletën në katër pjesë ose përdor katër fletë të plota.
- Përdor nga një model për secilën fletë.



Vlerëso krijimin tënd

Tregoju shokëve dhe shoqeve punimin tënd. Shpjego si i përgatite modelet për shtyp.

Mjetet e punës:

mollë, patate, portokall, limon etj., akuarel.

23. TEKNIKA E SHTYPIT (II)

Pema me mollë

Ndaj një mollë të vogël në dy pjesë.

Vizato trungun e pemës dhe disa degë.


Zgjidh ngjyrën e kuqe, portokalli dhe të verdhë për mollët dhe ngjyrën kafe për trungun e pemës.

Shtypi mollët e ngjyrosura në kurorën e pemës.



KRIJIMI IM

Vepra në të njëjtën mënyrë për të përgatitur një shportë me mollë.



Vlerëso krijimin tënd

Tregoju shokëve dhe shoqëve punimin tënd. Shpjego mënyrën se si realizove.

Mjetet e punës:

mollë, letër e bardhë, ngjyra uji.

24. TEKNIKA E SHTYPIT (III)

Krijoni së bashku **Pemën e miqësisë**.

- Vizatoni një pemë.
- Zgjidhni nga një ngjyrë secili dhe dorën e lyer me të, mbështeteni mbi kurorën e pemës.
- Shkruani emrin tuaj pranë shenjës së dorës që latë në pemë.



KRIJIMI YNË: PEMA E MIQËSISË



Vlerëso krijimin tënd


Diskutoni së bashku për pemën që realizuat.

Mjetet e punës:

një letër e madhe, laps, akualet, penela.


25. FORMA TREDIMENSIONALE

Shiko dhe lidh me shigjetë figurat gjeometrike me trupat përkatës.



Format gjeometrike janë **dydimensionale**, ato kanë gjatësi dhe gjerësi.

Trupat gjeometrikë janë **tredimensionalë**, Ata kanë gjatësi, gjerësi dhe lartësi.




Të gjitha objektet në natyrë janë tredimensionale.

EKSPERIMENTI IM

- 1 Merr një letër dhe rrotulloje rreth vetes për të krijuar cilindrin.



- 2 Ndaje letrën në katër pjesë të barabarta.
Palose letrën për të krijuar një prizëm me tri faqe.



Vlerëso krijimin tënd






Diskuto me shokët dhe shoqet e klasës për trupat gjeometrikë që krijove.

Mjetet e punës:

letër, ngjitës.

26. FORMA DY- DHE TREDIMENSIONALE

Shiko me vëmendje figurat. Ato do të të ndihmojnë të ndërtosh piramidën.



KRIJIMI IM

Ngjyros faqet e piramidës, si në figurë.

Përdor vija të llojeve të ndryshme dhe ngjyra sipas dëshirës. Prite figurën me gërshërë sipas vijave të përcaktuara (fig. 1). Vendos ngjitës në vendet e duhura, për të bashkuar faqet e piramidës (shiko te Fletorja e punës).




Fig. 1



Fig. 2

Vlerëso krijimin tënd


Diskuto me shokët dhe shoqet për dallimin mes formës dydimensionale dhe asaj tredimensionale.







Mjetet e punës:

letër e bardhë, flamastera ose lapsa me ngjyra, gërshërë, ngjitës.

27. TRUPAT GJEOMETRIKË ME PLASTELINË


Shiko dhe emërto trupat gjeometrikë të paraqitur në figurë.



KRIJIMI IM

Krijo edhe ti disa trupa gjeometrikë me plastelinë.



Vlerëso krijimin tënd

Diskuto me shokët dhe shoqet si i krijove trupat gjeometrikë.

Mjetet e punës:
plastelinë.

28. HAPËSIRA

Shiko sferat dhe gjej cila është më e madhe dhe cila më e vogël. Nëse sferat janë të barabarta me njëra-tjetrën, atëherë përse nuk duken njësoj?




Sferat janë të vendosura njëra pas tjetrës në hapësirë.

Hapësira është sipërfaqja ku qëndrojnë objektet.

Sferat që janë vendosur përpara, duken më të mëdha nga sferat që janë vendosur mbrapa.

EKSPERIMENTI IM

- Prit me gërshërë rrathët në *Fletoren e punës*.
 - Zgjidh një letër me ngjyrë.
 - Vendos mbi të rrathët njëri pas tjetrit, duke filluar nga më i madhi.
 - Ngjiti rrathët mbi letër.
- Në këtë mënyrë, krijove një krimb që lëviz.



Vlerëso krijimin tënd

Diskuto me shokët dhe shoqet e klasës si e krijove punimin tënd.

Mjetet e punës:

letër me ngjyrë, gërshërë, ngjitës.


29. TRADITA E POÇERISË

Shiko me vëmendje figurat.

Si mendon, me çfarë materiali janë krijuar enët e paraqitura në to?

A ke parë enë të ngjashme në shtëpinë tënde?

Po në zonën ku banon a diku tjetër?




Punimi i enëve është një traditë e hershme në vendin tonë.
Kjo traditë vazhdon edhe sot.

Materiali që përdoret për prodhimin e enëve quhet **argjilë**.

KRIJIMI IM

Realizo me plastelinë një enë të thjeshtë, duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

- Merr një copë plastelinë dhe krijo një sferë.
- Shtype sferën në mes me gishtin e madh.
- Vazhdo ta shtypësh duke e rrotulluar, për t'i dhënë formën e duhur.
- Shkruaj emrin tënd në enën që krijove.



Vlerëso krijimin tënd

Diskuto me shokët dhe shoqet e klasës si e realizove enën.

Mjetet e punës:
plastelinë, laps.

30. MOZAIKU


Shiko mozaikun dhe përshkruaj çfarë paraqet.
Cilat ngjyra janë përdorur në të?



Romakët krijojnë mozaikë me gurë shumëngjyrësh dhe copa xhami.
Me mozaikët, ata zbukuronin dyshemetë dhe muret e shtëpive.

KRIJIMI IM

Krijo një zog me teknikën e mozaikut, duke përdorur fara me ngjyra të ndryshme.



Vlerëso krijimin tënd

Diskuto me shokët dhe shoqet për mënyrën si e realizove mozaikun.

Mjetet e punës:

fara të ndryshme, laps, fletë vizatimi, ngjitës.

31. LULET E DIELLIT SIPAS VAN GOGUT

Shiko pikturën “Lulet e diellit”, të realizuar nga Van Gogu. Çfarë ngjyre ka përdorur piktori për sfondin (hapësirën pas luleve)?



Piktori holandez **Vinsent van Gog** (1853-1890), është shumë i njohur për përdorimin e ngjyrave të forta në pikturat e tij.

KRIJIMI IM

Krijo edhe ti një lule dielli, sipas Van Gogut.


1. Zgjidh një letër me ngjyrë për vazon dhe disa të tjera për lulet.




3. Zgjidh një letër me ngjyrë për ngjyrën e sfondit.



2. Vizato vazon me ndihmën e mësuesit/es.



4. Vizato lulen si në figurë. Ngjit disa fara luledielli në qendër të lules.



Vlerëso krijimin tënd


Tregoju shokëve dhe shoqëve punimin tënd. Shpjego hapat që ndoqe.

Mjetet e punës:

letra me ngjyra, laps, gërshërë, ngjitës, fara.

32. PEIZAZH VJESHTE SIPAS ISMAIL LULANIT

Shiko peizazhin e realizuar nga piktori Ismail Lulani.
Cila stinë mendoni se është?
Çfarë ngjyre ka sfondi? Po pemët?



Piktori **Ismail Lulani** lindi në Tuz të Malit të Zi. Ai është i njohur për stilin e veçantë dhe larminë e ngjyrave që ka përdorur në pikturat e tij.

KRIJIMI IM

Krijo edhe ti një peizazh vjeshte, duke përdorur teknikën e shtypit me gjethe. Përdor ngjyrat e vjeshtës.



Vlerëso krijimin tënd

Diskuto me shokët dhe shoqet për mënyrën si e realizove peizazhin.

Mjetet e punës:

gjethe të ndryshme, akualet.

33. KULLA SIPAS MUSLIM MULLIQIT

Shiko kullën e realizuar nga piktori Muslim Mulliqi. Çfarë veçorish kanë kullat? Me çfarë materiali janë ndërtuar ato?



Muslim Mulliqi lindi në Gjakovë. Në pikturat e tij, ai pasqyroi motive dhe imazhe nga Kosova. Kulla është një nga motivet simbolike të krijimtarisë së tij.

KRIJIMI IM

Vizato një kullë, ku të dallohen elementet kryesore të saj: dritaret, dera, çatia. Zgjidh një teksturë për çdo pjesë të kullës. Përdor lapsa me ngjyra ose pastele.



Vlerëso krijimin tënd

Diskuto me shokët dhe shoqet për mënyrën si e realizove kullën.

Mjetet e punës:

laps, lapsa me ngjyra ose pastele, tekstura të ndryshme.

34. KRAHASOJMË DY VEPRA ARTI

Shiko pikturat dhe përshkruaj çfarë dallon në to.



*"Një ditë e diel në parkun buzë lumit, në Paris",
Xhorxh Sera, 1884*



"Ditë me shi në Paris", Gustav Kailebot, 1877

Plotëso tabelën e mëposhtme.

Të veçantat	Të përbashkëtat	Të veçantat
<p>Piktura e parë</p> <p>Tema:</p> <hr/> <p>Ngjyrat:</p> <hr/> <p>Tekstura:</p> <hr/> <p>Veshja në lidhje me stinën:</p> <hr/> <p>Çadra përdoret për:</p> <hr/>	<p>Vendi që paraqesin:</p> <p>Periudha historike:</p> <hr/> <p>Objekte të ngjashme:</p> <hr/> <p>Lloji i veshjes:</p> <hr/>	<p>Piktura e dytë</p> <p>Tema:</p> <hr/> <p>Ngjyrat:</p> <hr/> <p>Tekstura:</p> <hr/> <p>Veshja në lidhje me stinën:</p> <hr/> <p>Çadra përdoret për:</p> <hr/>

35. VIZITË NË STUDION E PIKTORIT

Vendi ku punon piktori ose piktorja, quhet **studio**.



Piktorja meksikane, Frida Kahlo (1907-1954) duke punuar në studion e saj.



Piktorja Alije Vokshi (1945-2022) duke punuar në studion e saj.



Piktori Abdurrahim Buza (1905-1987), duke punuar në studion e tij.



Piktori Gjelosh Gjokaj (1933-2016), duke punuar në studion e tij.

- Organizoni së bashku me shokët dhe shoqet e klasës, një vizitë në studion e një piktori.



FJALORTHI

akuareli - teknikë e pikturës, e cila përfshin ngjyrat që treten në ujë.

forma dydimensionale - forma e sheshtë e objekteve me dy përmasa.

forma tredimensionale - forma e objekteve me tri përmasa.

hapësira - sipërfaqja ku qëndrojnë objektet.

kolazhi - teknikë artistike që realizohet me materiale të ndryshme, të cilat priten dhe ngjiten në fletë.

motivi - figurë që përsëritet në një sipërfaqe.

mozaiku - teknikë artistike që realizohet me copëza të vogla materialesh me ngjyra.

piktori - artisti që krijon piktura.

poçeria - teknikë tradicionale e punimit të enëve prej argjile.

tekstura - element që tregon karakteristikat e sipërfaqes së objekteve.

teknika e shtypit - teknikë artistike që realizohet nëpërmjet modelit të ngjyrosur, i cili lë gjurmë mbi sipërfaqen e fletës.

vija - elementi më kryesor i vizatimit. Vija mund të jetë e shumëllojshme.



REFERENCA

- Kurrikula lëndore/programi mësimor: *Edukatë figurative 1*; Republika e Kosovës, gusht, 2018.
- Udhëzues praktik për zbatimin e kurrikulës, fusha e kurrikulës Artet; Instituti Pedagogjik i Kosovës; Republika e Kosovës, mars 2014.
- *Eileen S. Prince, Art Is Every Day, Activities for the Home, Park, Museum, and City, Zephyr Press, Chicago, 2012*
- *Al Hurwitz&Michael Day, Children and Their Art: Methods for the Elementary School, Eighth Edition, Thomson Wadsworth, USA, 2007*
- *Eileen S. Prince - Art is Fundamental. Teaching the Elements and Principles of Art in Elementary School; Zephyr Press, Chicago, 2008.*
- *Eileen S. Prince - Art Matters: Strategies, Ideas, and Activities to Strengthen Learning Across the Curriculum; Zephyr Press, Chicago, 2002*
- *Rob Barnes - Teaching Art to Young Children 4-9; Routledge Falmer, London and New York, 2002.*
- *Angela Wenzel - 13 Art Techniques Children Should Know; Prestel Publishing, Munich-London-New York, 2013*
- *Gaitskell, Charles D., Hurwitz, Al, Day, Michael - Children and Their Art: Methods for the Elementary School; Harcourt College Publishers, 1982.*
- *Rudolf Arnheim - Arte e percezione visiva; Feltrinelli Editore, 1994.*
- <https://teachbesideme.Com/klee-art-lesson/>
<https://kinderart.Com/category/art-lessons/painting/>
<https://www.Artic.Edu/artworks/20684>
https://en.Wikipedia.Org/wiki/a_sunday_afternoon_on_the_island_of_la_grande_jatte
- Fotografitë e marra nga faqja: <https://www.dreamstime.com/>

